

SISTEMET E BRENDSHME PER RAPORTIMIN E SHKELJEVE – SINJALIZIMI

Raport vjetor për mirëfunksionimin e sistemeve të miratuara për vitin 2021

Sistemi i brendshëm për raportimin (sinjalizimin) e shkeljeve është vënë në zbatim në Bankën Intesa Sanpaolo Albania që prej muajit **tetor 2018**. Sistemi u mundëson punonjësve të Bankës të raportojnë, duke dërguar **një e-mail në konfidencialitet të plotë**, për fakte apo sjellje që mund të përbëjnë shkelje të rregullave që drejtojnë veprimtarinë bankare, ose sjellje të tjera të parregullta.

Ky sistem sinjalizimi është në përputhje të plotë me dispozitat e Kompanisë mëmë, e cila parashikon dy kanale komunikimi: kanal in kryesor; i cili administrohet nga Departamenti i Auditimit të Brendshëm, dhe dytësor: i cili drejtohet prej Këshillit Drejtues të Bankës.

Për këtë arsye, janë përpiluar rregullore të brendshme specifike, të cilat u janë komunikuar të gjithë punonjësve, duke iu shpjeguar qasjen në kanalet e sinjalizimit.

Gjatë vitit 2021 nuk ka pasur asnjë raportim apo sinjalizim.

Në çdo rast, secili sinjalizim do të trajtohet në respekt të plotë të konfidencialitetit, për të garantuar mbrojtjen e personave që raportojnë dhe për të shmangur të gjithë format e keqdashjes ose të veprimeve diskriminuese dhe të padrejta. Çdo person që sinjalizon do të marrë një njoftim specifik në lidhje me marrjen e sinjalizimit dhe mbylljen e raportit lidhur me sinjalizimin e tij/saj.

Sistemi i brendshëm i raportimit (sinjalizimit) është i integruar me proceset ekzistuese të raportimit në Bankë dhe shërben si një mundësi për të përhapur vlerat etike që karakterizojnë punonjësit dhe bashkëpunëtorët e Grupit Intesa Sanpaolo, si dhe për të forcuar kulturën e ligjshmërisë, duke përmirësuar në këtë mënyrë kulturën e përgjithshme të kompanisë.

Departamenti i Kontrollit të Brendshëm.